



Arrestivim
Gjeto

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

13047

20.05.2016.

Drejtuar: TË GJITHA DEGEVE DOGANORE

Për dijeni: DEPARTAMENTIT TË AKCIZËS
DEPARTAMENTIT TEKNIK
DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV
DEPARTAMENTIT OPERATIVO HETIMOR

MANUAL

Për

Përdorimin e modulit të Akcizës EMCS në sistemit informatik Asycuda World për operatorët e Akcizës që prodhojnë/përpunojnë produkte të akcizës “Pije Alkolike”

Me qëllim, administrimin korrekt të Ligjit Nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave 612 datë 05.09.2012 “Për Dispozitat zbatuese të ligjit të akcizës” i ndryshuar;

Me qëllim, informimin e plotë të operatorëve ekonomikë që prodhojnë/përpunojnë/stokojnë produkte të akcizës “Pije Alkolike” (birrë, verë, raki, pije alkolike) apo pulla fiskale, në lidhje me përdorimin e modulit të Akcizës EMCS;

Përkufizime:

Me termin “Pije Alkolike”, do të kuptojmë gjithë gamën e produkteve të pijeve alkolike të përmëduara në shtojcën nr. 1/II të ligjit nr.61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Me termin “Lëndë të Para”, do të kuptojmë gjithë lëndët e para me detyrim përdorimi DSHA-je sipas aneksit 15 të VKM-se nr.612 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit për Akcizat, i ndryshuar”.

Me qëllim, lehtësimin e procedurave gjatë kryerjes së veprimeve me magazinat fiskale në sistemin informatik Asycuda World;

Me qëllim, lehtësimin dhe thjeshtimin e procedurave të kontrollit të operatorëve të akcizës të cilët - prodhojnë/përpunojnë/stokojnë produkte të akcizës, Pije Alkolike;

Me qëllim, rakordimin sipas përcaktimeve të nenit 35 – 37 të ligjit 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe neneve 84 – 87 të VKM 612 datë 05.09.2012 “Për Dispozitat zbatuese të ligjit të akcizës” i ndryshuar;

Me qëllim, evidentimin e gjendjes kontabël të lëndëve të para dhe produkteve të akcizës që operatorët prodhojnë/përpunojnë/stokojnë produkte akcize nga sistemi Informatik;

Miratohet ky - Manual për Përdorimin e modulit të Akcizës EMCS në sistemit informatik Asycuda World” sipas hapave të mëposhtëm:

1. Magazinat fiskale të prodhimit/përpunim të produktit të akcizës “Pije Alkolike”

Hapi I

Në momentin e Importimit të lëndëve të para për prodhim të pijeve alkolike, bazuar në nenin 148 pika 1 e VKM NR. 612 datë 05.09.2012 “Për Dispozitat zbatuese të ligjit të akcizës”, i ndryshuar, përpilohet deklarata e Importit me destinacion Magazinën Fiskale (DAV IM4 me regjim 4700) për sasinë e lëndëve të para për prodhimin e “Pijeve Alkolike” sipas llojeve; Në këtë rast operatori i akcizës paguan të gjitha detyrimet doganore të Importit, me përjashtim të detyrimeve të akcizës nëse ka.

Hapi II

Përpilohet Dokumenti Shoqërues Administrativ DSHA në Import, për të gjithë sasinë e lëndëve të para për prodhimin e “Pijeve Alkolike” që përmban DAV IM 4 me regjim 4700. Në DSHA pasqyrohen sasi të lëndëve të para për prodhimin e “Pijeve Alkolike” sipas kategorive dhe kjo sasi duhet të korrespondojë me sasi të DAV IM4,. Në kutinë 19 të DSHA-së zgjidhet klasifikimi tarifor, i cili duhet të jetë i njëjtë me klasifikimin tarifor në DAV.

Hapi III

Në rast të mos funksionimit të modulit të akcizës për DSHA-në në Import, operatori duhet që të hartojë një DSHA manuale dhe më pas, të kryejë ngarkimin manual në magazinën tatimore, për sasinë e lëndëve të para për prodhimin e “Pijeve Alkolike”, që i korespondojnë sasisë së importuar në DAV IM4. Ngarkimi manual duhet të kryhet në klasifikimin tarifor në varësi të produkteve lëndë të para, për prodhim “Pije Alkolike” të Importuar. Në ngarkimin manual tek rubrika ‘Shënime’, të shënohen të dhëna mbi Nr. R të DAV dhe datën. Numri R i DAV të shënohet në serialin e ngarkimit manual.

Hapi IV

Në momentin e blerjes së “Lëndëve të para” në tregun vendas, operatori duhet që të kryejë ngarkimin manual në magazinën tatimore, për sasinë e “Lëndëve të Para”, që i korespondojnë sasisë së blerë me faturat përkatëse të blerjes (Faturë Tatimore Shitje etj). Ngarkimi manual duhet të kryhet në klasifikimin tarifor dhe në kategorinë përkatëse, me përshkrimin blerje sipas faturës nr. faturës ...datë...

Hapi V

Kur operatori fut në prodhim një sasi të caktuar “Lëndë të Parë” dhe prodhon “Pije Alkolike”, veprimet që duhet të kryhen në sistem janë si mëposhtë:

1. Operatori ngarkon manualisht në klasifikimin tarifor përkatës sasinë e “Pijeve Alkolike” të dalë nga prodhimi, me përshkrimin “prodhim i datës përkatëse”.
2. Operatori kryen DSHA shkatërrimi me tip lëvizje 6 (kutia 6.1 e DSHA-së), për lëndën e parë, e cila ka shërbyer për prodhimin e produktit të ngarkuar manualisht. Sasia e lëndës

së parë, që do të shkatërrohet duhet të jetë e bazuar në kartën teknologjike të miratuar, që operatori ka depozituar pranë autoriteteve doganore.

3. Për firot ligjore, të evidentuara gjatë operacioneve të thjeshta të njohura sipas ligjit dhe dispozitave në fuqi, operatori kryen DSHA firosh me tip levizje 5 (kutia 6.1 e DSHA-së), për produktin mbi të cilin ka konstatuar humbjen/firon si dhe te rubrika “shenime” jep detaje mbi firot e konstatuar duke i identifikuar se kujt periudhe i përkasin. Në rast të mosfunksionimit të DSHA-së tipi 5, operatori duhet të hartojë DSHA shkatërrimi të tipit 6 (kutia 6.1 e DSHA-së), për produktin mbi të cilin ka konstatuar humbjen/firon si dhe te rubrika “shenime” jep detaje mbi firot e konstatuar duke i identifikuar se kujt periudhe i përkasin.

Hapi VI

Kur operatorit fut në prodhim/përpunim produkte akcize “Pije Alkolike” për përfitim e një produkti tjetër “Pije Alkolike” p.sh: distilimi i verës për prodhim rakië ose përpunimi i alkolit etilik për prodhim pije alkolike”, veprimet që kryhen janë si më poshtë:

1. Operatori ngarkon manualisht në klasifikimin tarifor përkatës sasinë e “Pijeve Alkolike”, të dalë nga prodhimi me përshkrimin “prodhim i datës përkatëse”.
2. Operatori kryen DSHA shkatërrimi me tip levizje 6 (kutia 6.1 e DSHA-së), për produktin e akcizës “Pije Alkolike”, e cila ka shërbyer për prodhimin e produktit të ngarkuar manualisht. Sasia e “Pijeve Alkolike” që do të shkatërrohet duhet të jetë e bazuar në kartën teknologjike të miratuar që operatori ka depozituar pranë autoriteteve doganore.
3. Për firot ligjore të evidentuara gjatë operacioneve të thjeshta të njohura sipas ligjit dhe dispozitave në fuqi, operatori kryen DSHA firosh me tip levizje 5 (kutia 6.1 e DSHA-së), për produktin mbi të cilin ka konstatuar humbjen/firon si dhe te rubrika “shenime” jep detaje mbi firot e konstatuar duke i identifikuar se kujt periudhe i përkasin. Në rast të mosfunksionimit të DSHA-së tipi 5, operatori duhet të hartojë DSHA shkatërrimi të tipit 6 (kutia 6.1 e DSHA-së), për produktin mbi të cilin ka konstatuar humbjen/firon si dhe te rubrika “shenime” jep detaje mbi firot e konstatuar duke i identifikuar se kujt periudhe i përkasin.

Masa për tu ndërmarrë nga Degët Doganore Mbikqyrëse

Me qëllim evidentimin në çdo rast të çdo levizje të mallrave të akcizës apo lëndëve të para për prodhim të produkteve të akcizës të kryer nga ana e operatorëve të akcizës, bazuar në pikën 4 të nenit 54 të VKM nr. 612 datë 05.09.2012, “Dispozitat e Ligjit të Akcizës në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”, operatorët e akcizës të mbajnë në mënyrë manuale regjistrime mbi kontabilitetin e stokut (Blerje me DSHA, Import, prodhim, hedhje për konsum, levizje në pezullim, firo, shkatërrim).

Regjistrimet duhet të mbahen në regjistër, i cili përmban të dhënat sipas kërkesave të nenit 54 të VKM 612 datë 05.09.2012 Dispozitat e ligjit të akcizës në Republikën e Shqipërisë (si dhe të dhëna shtesë që gjykohen të nevojshme sipas specifikave të produkteve të akcizës). Regjistri duhet të jetë i sekretuar nga ana e Degës Doganore mbikqyrëse.

- Ngarkohen Degët Doganore Mbikqyrëse për njohjen e operatorëve të akcizës me këtë manual.

- Degët Doganore mbikqyrëse, të ushtrojnë kontrolle dokumentare dhe fizike pranë operatorëve të akcizës, përpara kryerjes së sistemeve përkatëse në magazinat fiskale të operatorëve të akcizës, në modulën e Akcizës EMCS.

Ky Manual hyn në fuqi menjëherë.

Pranvera FAGU (BEHUSHI)

DREJTORI PËRGJITHSHËM

